

PLANIFIKIMI I PROJEKTIT

Ky modul synon tu përshtatet një numri të madhë të kandidatëve të cilët planifikojnë projekte - për shembull: studentëve të universitetit për planifikimin e një projekti kërkimor, individëve për planifikimin e projekteve të ndërtimit të madhësive të ndryshme, menaxherëve të projekteve zhvillimore për krijimin e përmbajtjeve që lidhen me trajnimin, apo individëve që planifikojnë ngjarje siç janë konferenca të korporatave e deri tek planifikimi i dasmës.

Moduli fokusohet në përdorimin e programeve të menaxhimit të projektit për përgatitjen e planeve të projektit dhe monitorimin e projektit, përfshinë planifikimin dhe menaxhimin e kohës, shpenzimet, detyrat dhe burimet.

Me përfundimin e këtij moduli kandidati do të jetë në gjendje të:

- Kuptoj konceptet kyçe që lidhen me menaxhimin e projekteve
- Përdor një aplikacion të menaxhimit të projektit për të krijuar një projekt të ri dhe për të mbajtur financiarisht një projekt ekzistues
- Krijoj e planifikoj detyra dhe të regjistrojë afateve kufizuese të projektit
- Caktoj koston dhe të atribuoj resurset e duhura për secilën detyrë
- Shikoj dhe analizoj shtegun kritik të projektit, të monitoroj progresin dhe të riplanifikoj punën
- Përgatis dhe printoj rezultatet, duke përfshirë tabelat dhe raportet

Ju lutemi vini re se ky modul është zhvilluar së fundmi nga Fondacioni ECDL, andaj mund të mos jetë ende në dispozicion në vendin tuaj. Ju lutemi kontaktoni operatorin tuaj kombëtarë për të konfirmuar disponibilitetin e tij.

SI MUND TA MËSOJ KËTË MODUL?

Këtë modul mund ta mësoni nga librat dhe ushtrimet e librave në mënyrë autodidakte apo edhe duke ndjekur trajnimin e këtij moduli në ndonjë qendër testuese të ECDL-së. Për t'u përgatitur për provim ju rekomandojmë të ushtroni edhe me provimin mostër, të cilin mund ta shkarkoni nga ueb faqja jonë www.ecdl-kosova.org në linkun download.

Pasi ta keni mësuar këtë modul mund ta paraqitni provimin e këtij moduli në rubrikën Certifikimi.



Certifikatat e lëshuara nga ECDL Kosova vlejné ndërkombëtarisht.